



Prishtinë: 24.03.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_240\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_375\_03\_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-ë: ZRRE/DMK\_R\_375\_06\_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2010, morri këtë:**

#### **VENDIM**

**PRANOHET** ankesa e konsumatorit Kamber Dubovci (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 90022433) nga Drenasi, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

#### **Arsyetim**

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 08.05.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 24.04.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 08.11.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut e ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja e njehsori nr. 14038032 dhe ka vendosur njehsorin nr. 4851480.  
**Provë:** Procesverbali për ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 1544
- Me datë 27.12.2007 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit gjatë kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr. 14038032, kanë konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të manipuluar, pjesa kyçëse e djegur dhe numëruesi i manipuluar.  
**Provë:** Procesverbali nr. 27/27 të datës 27.12.2007
- Me datë 15.09.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë regjistruar të dhënat teknike të konsumatorit, profilin e kabllit furnizues, siguresat etj.  
**Provë:** Procesverbali nr. 169260 të datë 15.09.2008
- Me datë 21.10.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar sipas faturës DPR08HP06751 në shumë prej 3,123.77€  
**Provë:** Fatura DPR08HP06751 të datës 21.10.2008

- Me datë 21.10.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 24.04.2009 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në proceset e kontrollës dhe të kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 24.04.2009
- Me datë 08.05.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e KEK-ut në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Zyrtarët e autorizuar për kontrollimin e njehsorëve elektrik në laboratorin e qendrës së kalibrimit kanë konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të manipuluar, pjesa kyçëse e djegur dhe numëruesi i manipuluar, ky konstatim është bërë pa pjesëmarrjen e palës së tretë (përfaqësuesve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë apo përfaqësuesve të institucioneve të pavarura) ashtu siç është përcaktuar në nenin 7 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar.
- ✓ DMK në ZRRE pas analizimit të ankesës së konsumatorit ka vërejtur se gjatë shqyrtimit të ankesës nga KEK-u nuk është respektuar neni 12 i procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar saktësisht cila ka qenë në fuqi, pasi që KEK-u e ka faturuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të profilit të kabllit furnizues ndërsa është dashur ta faturoj sipas pajisjeve elektrike të cilat i posedon konsumatori.
- ✓ DMK në ZRRE pasi ka vlerësuar se ankesa e konsumatorit nuk është shqyrtuar saktë nga ana e KEK, me datë 15.06.2009 ka kërkuar nga KEK-u fillimin e procesit të negocimit mbështetur në kapitullin e 4 të Rregullës për zgjidhjen e kontesteve në Sektorin e Energjisë.
- ✓ KEK-u pas analizimit të ankesës së konsumatorit dhe duke u bazuar në kapitullin e 4 të rregullës për zgjidhjen e kontesteve në Sektorin e Energjisë ka pranuar për fillimin e procesit të negocimit me qëllim të zgjidhjes sa më të drejtë dhe të shpejt të ankesave të konsumatorëve.
- ✓ Me datë 08.07.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori dhe kanë regjistruar pajisjet elektrike në lokal.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 330651 të datës 08.07.2009
- ✓ Me datë 14.08.2009 KEK-u ka formuar një komision ekspertësh prej pesë menaxherëve ku ka analizuar detajisht ankesën e konsumatorit dhe ka dërguar në ZRRE një ofertë të re për konsumatorin.  
**Provë:** Raporti i KEK-ut i datës 14.08.2009
- ✓ DMK e ZRRE-së e ka informuar konsumatorin për ofertën e KEK-ut, por që konsumatori nuk ka pranuar ofertën e KEK-ut të datës 14.08.2009.

- ✓ Me datë 22.05.2001 konsumatori ka hapur biznesin sallon ondulomi D.P.T “Endi”, ku ka edhe certifikatën e biznesit të regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.  
**Provë:** Certifikata e Biznesit
- ✓ Mesatarja e energjisë elektrike në sezonën dimërore me njehsor të vjetër nr. 14038032 për periudhën 11/2005 – 03/2006 është **232.00 kWh**, ndërsa me njehsor të ri nr. 4851480 për periudhën 11/2007 – 03/2008 është **277.00 kWh**.  
**Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive
- ✓ Mesatarja e energjisë elektrike në sezonën verore me njehsor të vjetër nr. 14038032 për periudhën 04/2005 – 08/2005 është **552.00 kWh**, ndërsa me njehsor të ri nr. 44058121 për periudhën 04/2008 – 08/2008 është **552.60 kWh**.  
**Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive
- ✓ Sipas analizave të bëra rrjedhjes së energjisë aktive shihet se prej periudhës 11/2007 e deri në periudhë 08/2008 mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor nr. 44058121 është **414.80 kWh**.  
**Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive
- ✓ Sipas analizave të bëra rrjedhjes së energjisë elektrike shihet se prej periudhës 08/2002 e deri te periudha e ndërrimit të njehsorit elektrik 11/2007 mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike është **305.1 kWh**.  
**Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive
- ✓ Sipas analizave të bëra rrjedhjes së energjisë aktive shihet se prej periudhës 04/2006 e deri kur është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik periudha 11/2007, njehsori elektrik nuk ka regjistruar energji elektrike.  
**Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive
- ✓ Ndërrim i njehsorit elektrik është bërë me kërkesën e konsumatorit, ku është kërkuar të ndërrohet pasi që njehsori i mëparshëm ka qenë njëfazor ndërsa konsumatori ka dashur të vendos njehsor trefazor.  
**Provë:** Vërtetimi i ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 1544 të periudhës 11/2007
- ✓ Konsumatori në deklaratën e tij deklaron se lokalin e ka me qera dhe se në momentin e marrjes me qera njehsori elektrik me nr. 14038032, ka qenë i dëmtuar dhe se për shkak të kësaj ka kërkuar ndërrim njehsori. Konsumatori ka deklaruar se edhe para atij ka pasur qiramarrës tjerë të cilët e kanë pasur lokalin në posedim. Konsumatori poashtu deklaron se profili (seksioni) i kabllit furnizues ka qenë 2x1.5 mm<sup>2</sup>, ndërsa KEK-u e ka faturuar konsumatorin me profil të kabllit 4x4 mm<sup>2</sup>.  
**Provë:** Deklarata e konsumatorit
- ✓ Konsumatori ka të nënshkruar kontratën për qiramarrje mes pronarit Eset Leku dhe Kamer Dubovcit me datë 18.02.2005, poashtu me datë 01.01.2008 ka vazhduar kontratën për qiramarrje.  
**Provë:** Kontratat e qiradhënies
- ✓ Prej periudhës 10/2006 e deri kur është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik në periudhën 11/2008 njehsori elektrik i konsumatorit nuk ka regjistruar energji elektrike, DMK në ZRRE pasi ka pranuar nga KEK-u shumë e fuqive të shpenzuesve të inventarizuara ka kalkuluar

energjinë elektrike të shfrytëzuar nga konsumatori por të pa matur në njehsorin elektrik në vlerën prej 311.4 €.

- ✓ DMK e ZRRE-së duke marrë për bazë analizat e bëra rrjedhjes së energjisë aktive nuk ka mundur të vërejë se numëruesi është i manipuluar që do të reflektonte me zvogëlim të energjisë së konsumuar apo me ndonjë faturë negative. DMK pas këtyre analizave vjen në përfundim se nuk gjenden elemente se konsumatori ka bërë abuzim me njehsor, për periudhën të cilën ngarkohet.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmimeve të paraqitura rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranon pjesërisht** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vërejtur se prej periudhës 10/2006 e deri kur është bërë ndërrimi i njehsorit 11/2008 KEK-u nuk ka marrë ndonjë veprim për ndërrimin e njehsorit edhe përkundër asaj që njehsori i konsumatorit nuk ka qenë duke funksionuar dhe se konsumatori ka kërkuar nga KEK-u që të behët ndërrimi i njehsorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që të **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që

1. KEK-u duhet ta shkarkoj konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike DPR08HP06751 në vlerë prej 3,123.77 €.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar